



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr.55, datë 06.07.2016

Për

“DHËNIEN E TITULLIT “SIMBOL I QYTETIT TË TIRANËS” ZOTIT PANAJOT PANO”

Bazuar në nenin 8 pika 2, nenin 9/1.7 shkronja “a” dhe nenit 54 shkronja “m” të ligjit nr.139/2015, për “Vetëqeverisjen Vendore”, me propozim të Kryetarit të Këshillit Bashkiak, pasi mori në shqyrtim relacionin “Për dhënie e titullit “Simbol i qytetit të Tiranës”, zotit Panajot Pano, futbollist i njohur dhe simbol i Shqipërisë edhe jashtë kufijve, Këshilli Bashkiak i Tiranës,

V E N D O S I:

1. Të miratojë propozimin për dhënie e titullit “Simbol i Qytetit të Tiranës”, futbollistit të njohur Panajot Pano, me motivacionin:

“Në nderim të veprimtarisë dhe përkushtimit që ka dëshmuar për zhvillimin e sportit në vendin tonë dhe njohjes së tij edhe në aktivitete ndërkombëtare e botërore. Në respekt të vlerave që i përcolli brezave dhe pasionit që ngjalli e rriti për futbollin”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI